



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.15

Dhjetor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 26.11.2004

### PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale (MCC, S.p.A), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë – Fier dhe mbikqyrjen e punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë – Fier dhe Fier – Vlorë.

### VENDIME të Këshillit të Ministrave data 26.11.2004

1. Për bashkimin në një të vetme të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme “Tiranë 1” dhe “Tiranë 2” dhe për krijimin e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme Tiranë dhe Has, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 26.3.2004, nr.303, datë 16.4.1996, nr.676, datë 14.10.1996 dhe nr.157, datë 26.2.1998.

2. Për një ndryshim në vendimin nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e dhënies së lejes për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.

(Vijon në faqen 2)

## Nga Punimet e Kuvendit

### PËR MUAJIN NËNTOR 2004

1. P/ligji “Për veterinarinë”, miratuar në seancë plenare më datë 4 nëntor 2004).

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin e Përhershëm të Bujqësisë dhe Ushqimit u zhvilluan disa seanca dëgjimore me grupime dhe institucione të interesuara për të si Shoqata e Përpunuesve të Mishit, Instituti i Kërkimeve Veterinare, si dhe me ekspertët e ministrive të interesuara.

Deputetët e mbështetën projektligjin në parim dhe vlerësuan domosdoshmërinë e përmirësimeve që ai bën në ligjin ekzistues, siç janë plotësimi i boshllëqeve, përmirësimi i strukturës organizative të shërbimit veterinar, unifikimi i këtij shërbimi në mbarë vendin, krijimi i pavarësisë dhe dalja e tij jashtë strukturave të Drejtorive të Bujqësisë dhe Ushqimit, caktimi i kuadrit ligjor për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet disa dikastereve dhe përcaktimi i detyrave për bashkëpunimin me zyrën ndërkombëtare të epizootive të BE-së dhe me shërbimet veterinarë homologe të vendeve me të cilat kemi marrëveshje. Por, ndërkohë, gjatë diskutimit në parim

(Vijon në faqen 3)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave  
faqe 1-2

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore  
faqe 1

4. Nga punimet e Kuvendit për muajin nëntor 2004  
faqe 1,3

5. Kalendarit 2 javor i Kuvendit,  
6- 16 dhjetor 2004  
faqe 4-5

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Presidenca  
[www.president.al](http://www.president.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

3. Për caktimin e tarifës dhe të peshës së shërbimeve të rezervuara për operatorin publik postar.

4. Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjes - kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.

5. Për një shtesë në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore".

6. Për trajtimin e armatimit dhe të municionit trofe të Ministrisë së Rendit Publik.

7. Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.839, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e ushtarakeve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

8. Për transferimin në pronësi të bashkisë së Divjakës të pronave me numrat rendorë 869, 870, 871, 872 dhe 873, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

9. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004 për bashkinë e Tiranës, për mbulimin e shpenzimeve për festimin e 60 vjetorit të çlirimit të At-dheut.

10. Për miratimin në parim të ndryshimit të marrëveshjes për financimin e programit të zhvillimit të zonave malore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërko-mbëtar për Zhvillimin Bujqësor.

11. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

12. Për miratimin në parim të projekt-marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian, për menaxhimin e krizave në Bosnjë- Hercegovinë (Operacioni "ALTHEA").

13. Për miratimin në parim të protokollit shtesë "Për luftën kundër terrorizmit" të marrëveshjes ndërmjet qeverisë të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik në luftën kundër krimit veçanërisht në format e organizuara të tij.

14. Për disa ndryshime në vendimin nr. 64, datë 29.1.2004 të Këshillit

të Ministrave, "Për miratimin e programit analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2004".

15. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Skënder Malindi.

16. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Elamin Hado.

17. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Mevlan Dervishaj.

18. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Emil Qirko.

19. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Halim Ramohito.

20. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, zotit Kujtim Hysenaj.

21. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të zotit Dhori Kule në Itali.

22. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të fëmijës Erinda Bega në Itali.

## II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 3.12. 2004

### PROJEKTLIGJE

*(Vendime për propozime projektligjesh).*

1. Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve.

- Projektligji synon krijimin e strukturave dhe kushteve ligjore të vepërimit të një shërbimi të posaçëm me natyrë kryesisht informativo – gjurmuese, për të mundësuar mbledhjen dhe administrimin e informacionit lidhur me parandalimin apo zbulimin e veprave penale, të cilat kanë si subjekte punonjësit e burgjeve.

2. Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 "Për policinë e burgjeve".

- Projektligji parashikon ndryshime dhe plotësime lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e policisë së burgjeve për çështjet e kontrollit në mjediet e të dënuarve për sendet e ndaluara, parandalimin e ngjarjeve e tentativave për arratisje, kontrollin fizik të qytetarëve që venë në takim, të zyrtarëve që hyjnë në regjimet e të dënuarve dhe shoqërimin e garantimin e ruajtjes fizike të të paraburgosurve.

Gjithashtu ndryshime me rëndësi janë edhe ato lidhur me emërtimet e detyrave funksionale për krijimin

e hapsirave ligjore që kanë të bëjnë me hierarkinë në strukturat e policisë së burgjeve, duke zgjedhur edhe ndarjen e emërtimit të funksionit me emërtimin e gradave, plotësime në lidhje me procedurat e dhënies së gradave, përcaktimin e rasteve, të lirimit dhe largimit nga detyra, procedimet disiplinore dhe rregullimin e tyre me miratimin e Rregullores së Disiplinës etj.

## VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DATA 3.12.2004

1. Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile.

2. Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit.

3. Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

5. Për një ndryshim në vendimin nr.566, datë 27.8.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian për zhvillimin Ekonomik Arab, për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza III)".

6. Për miratimin në parim të marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane të Investimeve, për kontratën financiare të kësaj banke për projektin e ndërtimit të TEC-it, në Vlorë.

7. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, "Për rregullat e shërbimit të informacioneve dhe të dokumenteve të klasifikuara, në kuadër të operacionit "ALTHEA", në Bosnjë – Hercegovinë".

8. Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Suedisë, për mbështetjen e projektit të shërbimeve efçente të punësimit në Shqipëri.

9. Për lejimin e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit të përdorë, në emër të Ministrisë së Integritimit Europian, procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerjen e tre automjeteve.

10. Për shpalljen e muajit dhjetor "muaji i festimeve të Vitit të Ri".

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-30 NËNTOR 2004

*(Vijon nga faqja 1)*

deputetët theksuan nevojën për përmirësimin rrënjësor të disa neneve që siç ishin formuluar, penalizonin pa të drejtë përpunuesit e mishit, për rregullimin e atyre neneve që binin ndesh me parimet e OBT-së si dhe për mënjanimin e disa dispozitave të tjera që kishin përsëritje. Po kështu, ata theksuan nevojën për përmirësim strukturor të projektligjit, duke shtuar disa kapituj të rinj dhe nene të reja ose duke bërë zhvendosje kapitujsh e nenesh. Për ta bërë ligjin më të qartë e më konçiz, gati të gjitha dispozitat janë riformuluar.

Gjatë diskutimit deputetët theksuan se përmirësimet që sjell ligji i ri mund të arrihen vetëm me kryerjen e investimeve të domosdoshme dhe i kërkuan Këshillit të Ministrave që të marrë masa për planifikimin e fondit të nevojshëm për shërbimin dhe inspektoratin veterinar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2005.

## **2. P/ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncesionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k. për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “NËNË TEREZA”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare” (miratuar në seancë plenare më datë 11 nëntor 2004”**

Projektligji synon të ratifikojë kontratën e koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, të lidhur midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “Tirana Airport Partners”, shpk, e cila ka si partnerë kryesorë investitorë gjermanë dhe pjesërisht Fondin Amerikan të Ndërmarrjeve. Kontrata e koncesionit është ndërthurje e formës BOT me BOOT. Sipas formës së koncesionit të tipit BOT, koncesionarit i jepet në përdorim një pjesë e aseteve për një periudhë 20-vjeçare, ndërsa e drejta e pronësisë është e shtetit shqiptar. Sipas formës së koncesionit të tipit BOOT, koncesionarit i jepet një pjesë e aseteve në përdorim dhe në pronësi për një periudhë 20-vjeçare dhe pas kësaj periudhe, asetet i kalojnë në pronësi dhe në përdorim shtetit shqiptar.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët u shprehën dakord në parim me dhënien me koncesion të Aeroportit “Nënë Tereza”. Përfaqësuesit e Qeverisë informuan Kuvendin se marrëveshja e koncesionit ishte mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemit të ndërtimit të terminalit të Aeroportit dhe për shfrytëzimin e këtij terminali për një periudhë 20-vjeçare. Ata theksuan se koncesionari është një investitor strategjik serioz, me përvojë të gjatë në projektimin dhe ndërtimin e aeroporteve, se në hartimin e kontratës së koncesionit është patur në konsideratë mbrojtja e interesave të vendit, se ajo do të ndikojë në rritjen e ritmeve të zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe në hapjen e vendeve të reja të punës. Gjithashtu, ata theksuan se kushti i vendosur në kontratë për koncesionarin që të ngurtësojë në favor të Qeverisë Shqiptare një paradhënie prej 3 milionë Eurosh është një mjet garancie për kryerjen e investimit. De-

putetët e opozitës u shprehën dakord në parim me dhënien me koncesion të Aeroportit “Nënë Tereza”, e cila do të ndikojë në përmirësimin e nivelit të administrimit të tij, por ata kundërshtuan formulimin e kontratës së koncesionit, e cila sipas tyre, parashikon disa kushte të disfavorshme për vendin. Sipas tyre, përfitimet në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit janë të vogla, ndërsa të drejtat që i jepen koncesionarit janë tejkaluar. Ata u shprehën kundër dhënies së një sërë të drejtash koncesionarit si përjashtimit nga taksat e importit dhe TVSH-ja për të gjitha furnizimet e koncesionarit, destinacionit të të ardhurave nga taksat në favor të koncesionarit dhe në disfavor të Buxhetit të Shtetit, ekskluzivitetit që i jepet koncesionarit për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve tregtare dhe të shërbimeve në zonën e koncesionit, pagesave të taksave nga shteti për pronën që i jepet koncesionarit, ekskluzivitetit që i jepet Aeroportit “Nënë Tereza”, si i vetmi aeroport për fluturime ndërkombëtare, duke i hequr të drejtën ndonjë aeroporti tjetër që të përdoret për fluturime ndërkombëtare e tregtare, të drejtës së koncesionarit për të ndërtuar rrugën hyrëse Vorë-Rinas mbi bazën e huasë shtetërore të garantuar nga shteti, duke shkelur procedurat ligjore të prokurimit publik, llogaritjes së të ardhurave që do të ketë aeroporti mbi bazën e disa treguesve që janë mjaft të ulët në krahasim me mundësitë e tregut etj. Gjithashtu, disa deputetë theksuan se marrja e huasë shtetërore për ndërtimin e rrugës Vorë-Rinas, sipas Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, duhet të mbështetet në ligj dhe jo të parashikohet në kontratë, pa patur një ligj të tillë. Përfaqësuesit e Qeverisë kundërshtuan pretendimet e deputetëve të opozitës lidhur me termat e kontratës. Ata informuan Kuvendin se investimet e huaja kanë qenë të përjashtuara nga taksat deri në vitin 1996, se Aeroporti “Nënë Tereza” është aktualisht i përjashtuar nga TVSH-ja, se dhënia e së drejtës së aeroportit të vetëm për fluturime ndërkombëtare është mbështetur në përvojën e vendeve të tjera të vogla, në të cilat ka vetëm një aeroport për fluturime ndërkombëtare dhe se kontrata në përgjithësi është e favorshme për shtetin shqiptar. Në përfundim, projektligji u miratua me shumicë votash.

## **3. P/ligji “Për barnat dhe shërbimet farmaceutike” (miratuar në seancë plenare më datë 25 nëntor 2004).**

Ky projektligj synon të pasqyrojë ndryshimet që janë bërë në sektorin e shëndetësisë si rezultat i zhvillimit të tij të shpejtë, si dhe standardet europiane mbi tregtimin dhe fabrikimin e barnave për rritjen e shërbimit farmaceutik. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Përhershëm të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit deputetët mbështetën ndryshimet në formulimin e disa neneve të projektligjit, të propozuara nga ekspertët e fushës së shërbimit farmaceutik, shoqatat farmaceutike dhe sindikatat e farmacistëve, të cilat më pas u mbështetën edhe nga Kuvendi në seancë plenare. Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (6-16 DHJETOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

**E hënë, datë 6.12.2004, ora 10.00**

**- Seancë Plenare**

- Miratimi i Kalendarit të punimeve të Kuvendit.

1. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Eksport – Import të Koresë për projektin e elektrifikimit të zonave rurale".
2. P/ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore".
3. P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar (dy p/ligje).
4. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8978, datë 12.12.2002 "Për taksat vendore mbi biznesin e vogël".
5. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për Akcizat", të ndryshuar.
6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".
7. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e

niveleve të Tarifës Doganore", të ndryshuar".

8. P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
9. P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar.
10. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**Për votim:**

1. Propozimi i dy kandidatave për Kryetarin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.
  1. Halil Lalaj
  2. Lazër Stani

**E Martë, datë 7 – 15. 12. 2004**

**Punë në Komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:**

1. P/ligji "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005".

**- Të gjitha Komisionet e Përhershme sipas programit të veçantë**

2. P/ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e KIOTO-s, të

Konventës të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Shëndetësisë**

3. P/ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin ndryshuar të Koventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Mjeteve të Informimit Publik**

4. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillimin ndërkombëtar për projektin e menaxhimit të burimeve ujore".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Industrisë**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

5. P/ligji "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj" (paraqitur nga një grup deputetësh).

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financave)**

*(Vijon në faqen 5)*



# Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 4)

6. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8732, datë 24.1.2001 “Për shërbimin e mbrojtjes në bimëve”.

**-Komisioni i Ligjeve  
-Komisioni i Bujqësisë dhe  
Ushqimit (e ka  
shqyrtuar)**

7. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

**-Komisioni i Ligjeve  
-Komisioni i Ekonomisë  
dhe Financës**

8. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

**-Komisioni i Ligjeve  
-Komisioni i Ekonomisë  
dhe Financës**

**E Enjte, datë 16.12.2004,  
ora 10.00**

**-Seancë Plenare**

1. P/ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e KIOTO- s, të Konventës të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike”.
2. P/ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në

Protokollin ndryshuar të Koventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar”.

3. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillimin ndërkombëtar për projektin e menaxhimit të burimeve ujore”.

4. P/ligji “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të panvarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” (paraqitur nga një grup deputetësh).

5. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

6. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”.

## Njoftim

**Të nderuar zonja e zotërinj,**  
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)